



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Nr. 55 prot.

Kamëz, më 19.04.2021

V E N D I M

Nr. 46, datë 19.04.2021

Propozimin e dhënies së ndihmës financiare prej 321 933 (treqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë për familjen e z. Alban Fiqiri NOKA, banues në Rr “Jezerca”, Bathore 7, Lagjia Administrative Bathore, Bashkia Kamëz, të cilit i është djegur shtëpia me datë 13.2.2021.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.04.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt – Nr.41 Datë 16.04.2021** Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe V.K.B Kamëz Nr. 60, datë 23.12.2019 “Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606; **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej 321 933 (treqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë për familjen e z. Alban Fiqiri NOKA, banues në Rr “Jezerca”, Bathore 7, Lagjia Administrative Bathore, Bashkia Kamëz, të cilit i është djegur shtëpia me datë 13.2.2021.
2. Shuma 100 000 (njëqind mijë) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz 2021, struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606.
3. Shuma tjetër prej 221 933 (dyqind e njëzet e njëmijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë të financohet po nga Buxheti i Bashkisë pas rishikimit të realizimit të të ardhurave për vitin 2021 pasi nuk ka mundësi për të bërë mbulimin e këtij fondi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli

Ali Dauti

